

URDHËR
Nr. 874, datë 31.8.2026

**PËR SHFUQIZIMIN E URDHRAVE TË MINISTRIT TË BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL NR. 481, DATË 4.5.2026, NR. 530, DATË 15.5.2026 DHE
NR. 707, DATË 6.7.2026 “PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR
PARANDALIMIN DHE KONTROLLIN E SËMUNDJES SË MURTAJËS SË
RUMINANTËVE TË VEGJËL”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, nenit 113 të Kodit të Procedurave Administrative dhe shkronjës “d”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000 datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrave të Ministrit të Bujqësisë, si më poshtë:
 - a) urdhri nr. 481, datë 4.5.2026, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël”;
 - b) urdhri nr. 530, datë 15.5.2026, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël”;
 - c) urdhri nr. 707, datë 6.7.2026, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël”.
 2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL**
Andis Salla